



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/320
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K4/I23-2 Prot.
Nr. Dok. 202502548/2

Tiranë 27/08/2025

Lënda : Rekomandime për inspektimin e bërë në Komisaratin e Policisë Lushnje.

Drejtuar: **Z. Ilir PRODA**
Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit

TIRANË

Z. Skënder HITAJ
Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë

FIER

Z. Gerald TOSKA
Shef i Komisaratisë të Policisë

LUSHNJE

Të nderuar,

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm dhe duke vlerësuar angazhimin dhe punën e të gjithë stafit të institucionit që ju drejtoni, si dhe frymën e mirë të bashkëpunimit dhe mirëkuptimit midis institucioneve tona, në vijim po ju njohim mbi gjetjet e inspektimit periodik që institucioni i Avokatit të Popullit kreu në Komisaratin e Policisë Lushnje në datën 20.03.2025.

Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), seksion pranë Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar dhe nenin 81 të ligjit nr. 81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", kreu një inspektim në Komisaratin e Policisë në Lushnje.

Inspektimi u krye sipas një Plani Vjetor Inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin znj. Gloria Çarkaxhiu, znj. Nertila Qafzezi dhe z. Hazbi Selita me detyrë Nd/Komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr. 82/2024 "Për Policinë e Shtetit", Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. Urdhër 1720, datë 20.11. 2023 për miratimin e procedurës

standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre” dhe Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022, për miratimin e procedurës standarde “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë” si dhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra në inspektimin e një viti më parë. Inspektimi ishte i paparalajmëruar.

Avokati i Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga inspektimi i vitit të kaluar¹, ka detyrimin ligjor t’ju parashtojë konkluzionet përfundimtare, duke ju referuar si më poshtë vijon:

Shënime të përgjithshme

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetas të privuar nga liria, grupi i punës u takua me Shefin e Komisarariatit, z. Gerald Toska i cili u vu në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Drejtuesi i komisarariatit, informoi grupin e inspektimit mbi masat e marra për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Avokati i Popullit referuar inspektimit të mëparshëm, lidhur me përmirësimin e kushteve të ambienteve të shoqërimit të këtij Komisaritati sipas procedurave standarde dhe për rritjen e performancës së punonjësve të policisë për respektimin e të drejtave ligjore të shtetasve të shoqëruar, arrestuar/ndaluar.

Grupi i inspektimit, pasi mori informacionin e nevojshëm vijoi takimin me punonjësit e policisë që shërbenin në zyrën e informacionit dhe në dhomat e shoqërimit. Theksojmë se, punonjësit e policisë u treguan bashkëpunues dhe transparentë gjatë komunikimit dhe inspektimit, që zhvilloi grupi inspektues në ambientet e këtij Komisaritati.

Grupi i inspektimit, në vijim inspektoi ambientet e shoqërimit, zyrat e punonjësve të policisë, si dhe u njoh me dokumentacionin përkatës ku pasqyroheshin veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar apo ndaluar.

Nga monitorimi i zyrave të oficerëve të policisë gjyqësore, nuk u gjetën sende prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale. Në këtë Komisarariat **nuk kishte** një dhomë magazinë për administrimin dhe ruajtjen e provave materiale, të administruara gjatë procedimeve penale nga specialistët e krimeve si dhe materialet e tjera të ndryshme. Por në hyrje të ambienteve të këtij komisaritati, në të majtë ndodhet një godinë një katëshe e cila ka 2 dhoma të cilat janë jashtë funksioni dhe që mund të përshtaten për këtë qëllim. Sipas informacionit të drejtuesit të këtij komisaritati po vlerësoheshe që këto dhoma të vireshin në funksion për administrimin dhe ruajtjen e provave materiale.

¹ Rekomandimi i dërguar me nr. K4/I36-2 prot., datë 3.07.2024, “Rekomandime për inspektimin e bërë në Komisariatin e Policisë Lushnje”.

Nga informacioni i punonjësve të komisariatit, si dhe nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm², rezultoi se:

- Ishin marrë masa nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për ndërtimin e ambienteve të përshtatshme sipas kërkesave të parashikuara në ligjin nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit” dhe procedurën standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit*”, miratuar me Urdhrin Nr. 938, datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, të ndara më vete për personat e rritur, gra dhe të mitur.
- Ishin marrë masa për afishimin të listës të përditësuar me avokatë mbrojtës të miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe organi i prokurorisë, me qëllim sigurimin e avokatëve kryesisht që nga momenti i privimit të lirisë të personit, në rastin kur i shoqëruari/ndaluar/arrestuari nuk ka mundësi financiare të mbrohet me avokat.
- Kanë informuar institucionin e Avokatit të Popullit lidhur me zbatimin e planit të investimeve për vitin 2024 në të cilin është parashikuar fondi për zbatimin e projektit “*Rikonstruksioni i dhomave të Shoqërimit*” në Komisaratin e Policisë Lushnjë³.

Ndërkohë, grupi inspektimit konstatoi se:

- Nuk ishin marrë masat e nevojshme nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për krijimin e zyrave të përshtatshme për marrjen në pyetje/intervistimin e shtetasve gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore.
- Nuk ishin marrë masat e nevojshme nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për krijimin e zyrave të posaçme për intervistim me persona të mitur, duke ofruar një ambient të përshtatshëm që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me fëmijët.
- Nuk ishin marrë masa për plotësimin me saktësi të regjistrit të të miturve në konflikt me ligjin si dhe sigurimi i psikologut në çdo rast gjatë intervistimit të të miturve.
- Nuk ishin marrë masa për dhënien e kartës së të drejtave personave të shoqëruar apo ndaluar madhorë në momentin e hyrjes së tyre në ambientet e komisariatit.

Avokati i Popullit vëren se edhe përgjatë inspektimit të vitit 2025 situata është përmirësuar nga ana infrastrukturore pasi është kryer rikonstruksioni dhe vënia në funksion e tre dhomave të shoqërimit, megjithatë në përfundim të inspektimit konstatojmë ende mjaft problematika të cilat lidhen ngushtësisht me respektimin e të drejtave të personave që shoqërohen në organet e Policisë së Shtetit si më poshtë vijon:

Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre

² Rekomandimi i dërguar me nr. K4/I36-2 prot., datë 3.07.2024.

³ Shkresa nr.7502/1 prot., datë 01.10.2024 “*Mbi rekomandimet e Avokatit të Popullit për inspektimin e kryer në ambientet e shoqërimit në Komisaratin e Policisë Lushnje*” i DPPSH-së.

Në Komisarlatin e Policisë Lushnjë, ambienti i shoqërimit ishte ndërtuar sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, si dhe në procedurën standarde “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë” miratuar me Urdhër nr. 894, datë 19.07.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Mjedisi i shoqërimit **ishte ndërtuar në katin e parë**, brenda territorit të Komisarlatit të Policisë Lushnje dhe kishte 3 (tre) dhoma shoqërimi, të cilat ndaheshin në 1 (një) dhomë shoqërimi për meshkujt madhorë, 1 (një) dhomë shoqërimi për gra dhe 1 (një) dhomë shoqërimi për të mitur.

Dhomat e reja të shoqërimit që ishin ndërtuar rishtazi në këtë Komisarlat ishin me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim, ishin të pajisura me dritare të cilat lejonin ajrimin dhe ndriçimin natyral, si dhe kishin ndriçim nga rrjeti elektrik.

Dhomat e shoqërimit ishin të pastra nga ana higjieno-sanitare, ishin të lyera dhe të pajisura provizorisht me orenditë e nevojshme, si tavolinë dhe dy karrige, mirëpo mungonin stolat për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar, kjo për arsye se sipas shefit të komisarlatit dhomat ishin vënë në funksion rishtazi dhe ishin në proces të kompletimit të plotë të tyre .

Në korridorin e dhomave të shoqërimit ndodheshin dhe funksiononin tualetet, të ndara më vete për gratë dhe burrat, me sipërfaqe të mjaftueshme dhe të kompletuara me lavaman e rubinet për ujë, si dhe me pajisjet e nevojshme hidrosanitare.

Dritaret e dhomave të shoqërimit⁴ ishin të siguruara me skarë hekuri në pjesën e jashtme, me qëllim parandalimin e largimit apo arratisjes së personave të shoqëruar nga këto mjedise por **nuk ishin veshur me rrjetë teli** për të parandaluar çdo mundësi vetëdëmtimi të personave të cilët akomodohen në këto ambiente. Dritaret ishin me përmasa të tilla që krijojnë mundësinë e ajrimit dhe ndriçimit të plotë natyral. Në dhoma kishte edhe ndriçim artificial që furnizohej nga rrjeti elektrik.

Dyert e dhomave të shoqërimit⁵ ishin prej materiali druri masiv të fortë dhe të staxhionuara dhe nga ana e brendshme përforcohen me një fletë llamarinë e cila ishte e montuar dhe e puthitur me sipërfaqen e drurit të derës duke eliminuar/fshehur tehet prerës të saj, mbylleshin me çelës nga jashtë dhe me dorezë në të dy krahët e saj bazuar kjo në normat dhe standardet që parashikohen në Urdhër nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Në pjesën e sipërme të dyerve kishte një hapësirë me përmasa 60 x 40 cm, në të cilën ishte montuar një xham transparent dhe i armuar. Hapësira e dritares/sportelit të derës nga ana e korridorit të dhomave siguroheshe me një rrjetë teli me shufra me seksion/trashësi 0,6 mm të cilat vendosen në mënyrë vertikale dhe horizontale duke krijuar kuadrate 5 x 5 cm”.

⁴ Kreu VI, neni 4, pikat e.8 dhe e.9 ku parashikohen normat dhe standardet që duhet të plotësojnë dritaret e dhomave të ambienteve të shoqërimit

⁵ Kreu VI, neni 4, pika e.6 ku parashikohen normat dhe standardet që duhet të plotësojnë dyert e dhomave të ambienteve të shoqërimit.

Ambientet e shoqërimit si dhe brenda dhomave të shoqërimit ishin instaluar sistemi i monitorimit me kamera për mbajtjen në vëzhgim të ambienteve të brendshme të dhomave të shoqërimit. Gjatë kohës së kryerjes së inspektimit, nuk kishte persona të shoqëruar.

Në ambientet e shoqërimit në Komisaratin e Policisë Lushnje kishte sistem ngrohje/ftohjeje me anë të kondicionimit në çdo dhomë.

Në Komisarati e Policisë Lushnjë, gjatë periudhës 01.01.2025 deri më 20.03.2025 ishin të shoqëruar, të ndaluar apo të arrestuar dhe të evidentuar në regjistrin e shoqërimit 48 persona të shoqëruar nga të cilët 46 burra dhe 2 të mitur. Nga këqyrja e regjistrit të shoqërimit mesatarja e qëndrimit në komisarati e personave të shoqëruar ishte deri në 5 orë. Në momentin e inspektimit, nuk kishte asnjë shtetas në dhomat e shoqërimit.

Në ambientin e shoqërimit **nuk ishin të afishuara posterat** me të drejtat e personave të shoqëruar.

Gjatë inspektimit, grupi i monitorimit nuk konstatoi në ambientin e shoqërimit, sende apo mjete të tilla që mund të shërbejnë për kryerjen e vetëvrasjeve apo për kundërveprim ndaj punonjësve të policisë.

Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar dhe evidentimi i tyre

Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisaratin e policisë Lushnjë, “*Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar*” ishte plotësuar në zbatim të ligjit nr.82/2024 “*Për Policinë e Shtetit*”, sipas tipit “*Model nr.1*”, konform procedurave standarde “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*” miratuar me Urdhër nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, dhe ishte i sekretuar.

Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr. 82/2024 “*Për Policinë e Shtetit*”, regjistroheshin në këtë regjister nga punonjësit e zyrës së informacionit.

Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 5 orë në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrit ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë. Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson uljen e kohës së ndalimit të përkohshëm, në ligjin nr. 82/2024, “*Për Policinë e Shtetit*”, i cili fillon që në momentin kur punonjësi ndalon personin dhe zgjat deri në sqarimin e çështjes, por **në asnjë rast më shumë se 5 orë**.

Gjithashtu, përgjatë inspektimit konstatuam se personave të shoqëruar nga policia **nuk ju jepej informacioni për të drejtat e tyre në formë shkresore**, që nga fillimi i privimit të lirisë, për të siguruar informim të qartë në lidhje me të drejtat ligjore/procedurale që ata kanë. Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës

sugjeron dhënien e kartës të drejtave që në momentin e hyrjes në Komisarariat⁶. Rekomandimi i Komiteti i Parandalimit të Torturës (KPT), në përmbajtjen e tij nënkupton që karta me të drejtat që gëzojnë personat kur hyjnë në mjediset e policisë, duhet t'u jepet edhe personave që mbahen në dhomat e shoqërimit, pra që në momentet e para të privimit të lirisë. Kjo, pasi këtyre personave ju kufizohet liria deri në 5 orë (maksimumi) qëndrimi në dhomat e shoqërimit, ata merren në pyetje nga specialistët e policisë apo kanë të drejtë për njoftimin e familjarëve të tyre, e drejta për qasje me avokat mbrojtës, etj.

Në zyrën e informacionit të Komisarariatit të Policisë Lushnje kishte një regjistër më vete për evidentimin e të dhënave të personave të mitur të shoqëruar, bazuar në rekomandimin e Avokatit të Popullit për këtë qëllim⁷. Por nga këqyrja e këtij regjistri u evidentua se në disa raste **mungonte evidentimi dhe plotësimi i regjistrit në rubrikën** “*Persona të pranishëm gjatë intervistimit (prindi, mbrojtësi ligjor, psikolog, përfaqësuesi ligjor)*” kur është intervistuar.⁸

Komisariati i Policisë Lushnjë **nuk ishte i pajisur** me një regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar. Gjithashtu, bazuar edhe në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022, për miratimin e procedurës standarde “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*” konkretisht në Kreun VI, pika 1, gërma “I”, parashikohet se personi i shoqëruar ka të drejtën “*Të paraqesë kërkesa apo ankesa për mënyrën e shoqërimit, mbajtjes, trajtimit dhe respektimit të të drejtave nga personeli policor gjatë shoqërimit dhe mbajtjes në ambientet e policisë*”.

Avokati i Popullit tërheq vëmendjen se plotësimi i regjistrave në kohë dhe me korrektësi është një standard themelor me funksion parandalues për të garantuar të drejtat e njeriut.

Ambientet e sigurisë/kushtet e tyre dhe trajtimi i të ndaluarve/arrestuarve dhe i të shoqëruarve.

Në Komisariatin e Policisë Lushnje nuk kishte ambiente të sigurisë pasi ato ishin mbyllur në përputhje me rekomandimet e mëparshme të institucionit të Avokatit të Popullit dhe personat e arrestuar/ndaluar dërgoheshin në dhomat e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Fier.

Ambientet e intervistimit

Në Komisariatin e Policisë Lushnjë, **nuk ka një dhomë më vete të monitoruar me sistemin e kamerave, që të shërbejë për intervistimin/ marrjen në pyetje të**

⁶ Raporti i Komitetit Europian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit Çnjerëzor dhe Degradues (KPT), gjatë vizitës së tyre në Shqipëri në datat 4 - 15 Maj 2023.

⁷ Rekomandim nr.437 prot., datë 11.10.2019 “Për garantimin e të drejtave të të miturve të privuar nga liria në zbatim të legjislacionit të ri të administrimit të drejtësisë penale për të mitur”.

⁸ Urdhri nr. Nr. 756, datë 10.08. 08.2021 “Për miratimin dhe vënien në funksionim të Regjistrit të Evidentimit të të Dhënave për Personat e Shoqëruar të Mitur (14 – 18 vjeç), në ambientet e Policisë së Shtetit”, të D.P.P Sh.”

personave të shoqëruar nga punonjësit e policisë. Në raportin drejtuar Qeverisë Shqiptare mbi vizitën e KPT në Shqipëri të kryer në datat 4-15 maj 2023 është evidentuar qartë nevoja e krijimit të dhomave të intervistimit⁹: Në fakt, një strukturë e tillë mund të sigurojë një regjistrim të plotë dhe autentik të procesit të intervistimit, duke lehtësuar në masë të madhe hetimin e çdo pretendimi për keqtrajtim. Ky fakt është në interes si të personave që janë keqtrajtuar nga policia, ashtu edhe të punonjësve të policisë që janë përballur me pretendime të pabaza se janë përfshirë në keqtrajtime fizike apo presione psikologjike.

Në parim, regjistrimi audio-vizual duhet të mbulojë të gjitha fazat e marrjes në pyetje nga policia, duke përfshirë dhënien e informacionit për të drejtat në fillim të intervistës. Kjo do të sigurojë që marrja në pyetje nga ana e policisë të kryhet në përputhje me ligjin dhe do të ndihmojë në parandalimin e çdo praktike të nënshtrimit të personave të ndaluar në marrje në pyetje joformale përpara marrjes në pyetje zyrtare. KPT inkurajon autoritetet shqiptare të zgjerojnë aplikimin e regjistrimit audio-vizual të intervistave të policisë për marrjen në pyetje të të gjithë personave të ndaluar.

Avokati i Popullit e konsideron procesin e intervistimit të personave të shoqëruar në një ambient më vete, që të jetë i monitoruar nëpërmjet sistemit të kamerave të sigurisë, si një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi monitorimi filmik ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit ndaj tyre.

Gjithashtu, edhe intervistimi apo marrja në pyetje e të miturve në konflikt me ligjin që shoqërohen në mjediset e këtij komisariati, kryhej në zyrat e punës të punonjësve të policisë dhe jo në ambiente të veçanta, sikurse është e parashikuar në dispozitat e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur dhe procedurën standarde¹⁰. Mekanizmi Kombëtar e konsideron me rëndësi të veçantë faktin se, intervistat me të miturit duhet të realizohen në një ambient të përshtatshëm dhe të pajisur me orënditë e nevojshme si tavolina dhe karrige, në një mjedis sa më të qetë, pa shtrëngime fizike dhe presione psikologjike. Në kushtet aktuale që ndodhen zyrat e punës të punonjësve të policisë, intervistimi i tyre mund të shkaktojë traumatizim plotësues të të miturit.

Ndihma juridike dhe psikologjike

Grupi i inspektimit konstatoi se në momentin e inspektimit, në dhomat e shoqërimit nuk kishte asnjë person të shoqëruar. Në mungesë të tyre, u intervistuan punonjësit e policisë që kryejnë veprime procedurale me personat e shoqëruar, ku rezultoi se, në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit madhorë nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat dhe kërkonin ndihmë juridike, atyre iu sigurohej asistencë ligjore apo mbrojtja me avokat kryesisht.

⁹ electronic recording of police interview, fq.13, <https://rm.coe.int/1680ae233b>.

¹⁰ Kreu VII. Pika 2.1/k e procedurës standarde thuhet se: “I mituri në konflikt me ligjin gëzon të drejtat e parashikuara në Kodin e Procedurës Penale si dhe të drejtat e posaçme të parashikuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur”. I mituri duhet të mbahet në dhoma/ambiente të ndarë nga personat madhorë dhe të ndarë nga të miturit e tjerë sipas gjinisë”.

Përgjatë inspektimit në komisariatit e policisë Lushnjë, u konstatua se kishte një listë të afishuar në ambientet e komisariatit ku mund të evidentoheshin avokatët kryesisht. Kjo problematikë është trajtuar në raport drejtuar Qeverisë Shqiptare mbi vizitën e KPT në Shqipëri të kryer në datat 4-15 maj 2023. KPT-ja bën rekomandime për të përmirësuar funksionimin në praktikë të masave mbrojtëse ligjore. Kërkohej gjithashtu veprim për të siguruar që të gjithë personat e ndaluar nga policia të jenë plotësisht të informuar për të drejtat e tyre që nga fillimi i heqjes së lirisë. KPT-ja gjatë vizitës në organet e policisë së Shtetit ka konstatuar se: “Ka pretendime se oficerët e policisë kishin pranuar kërkesat e personave të shoqëruar arrestuar/ndaluar për avokat *kryesisht* vetëm pas një vonese të konsiderueshme, në mënyrë që të mund t’i pyesnin ata në mënyrë joformale për veprën e dyshuar pa praninë e një avokati”¹¹.

Përgjatë inspektimit punonjësit e policisë i parashtruan grupit të inspektimit, se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut. Prania e psikologut në këtë Komisariat, sigurohej nga Bashkia Lushnje.

Në rastet kur të shoqëruarit paraqesin probleme shëndetësore, punonjësit e policisë lajmëronin urgjencën dhe i shoqëronin ata në Spitalin e Qytetit të Lushnjës.

Gjatë inspektimit u konstatua se, brenda në dhomën e shoqërimit, nuk ishin afishuara ende posterat me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në organin e policisë, si dhe të personave të ndaluar/arrestuar. Sipas informacionit të shefit të komisariatit posterat e rinj me ndryshimet e fundit ligjore ishin në proces prokurimi nga Drejtoria e Policisë Fier për të gjitha komisariatet në varësi të kësaj drejtorie.

Grupi i inspektimit të Avokatit të Popullit këqyri disa praktika të njëpasnjëshme ku në përfundim të procedurave dhe veprimeve të kryera nga punonjësit e policisë në Komisariatit e Policisë Lushnjë, u konstatua se disa nga “Procesverbalet e Shoqërimit”, ishin të plotësuar korrekt në rubrikat e tij.

Për sa më sipër dhe me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike” dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr. 8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”,

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të nevojshme nga Drejtoria Vendore e Policisë Fier për pajisjen me orënditë e nevojshme të ambienteve të shoqërimit sipas kërkesave të parashikuara në procedurën standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në

¹¹ <https://rm.coe.int/1680ae233b>, raport drejtuar Qeverisë Shqiptare mbi vizitën e KPT në Shqipëri të kryer në datat 4-15 maj 2023.

mjediset e Policisë së Shtetit”, miratuar me Urdhrin Nr. 892, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

2. Marrjen e masave të nevojshme nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për krijimin e zyrave të përshtatshme për marrjen në pyetje/intervistimin e shtetasve gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore në Komisariatit të Policisë Lushnje.
3. Marrjen e masave të nevojshme nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për krijimin e zyrave të posaçme për intervistim me persona të mitur në Komisariatit të Policisë Lushnje duke ofruar një ambient të përshtatshëm që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me fëmijët.
4. Marrjen e masave nga Drejtoria Vendore e Policisë Fier për vlerësimin dhe ndërhyrjen për përshtatjen e dhomave ekzistuese të cilat janë të mbyllura në godinën një katëshe në hyrje të Komisariatit Lushnje me qëllim krijimin e magazinës për mbajtjen dhe administrimin e provave materiale.
5. Marrjen e masave për afishimin e posterave të rinj me të drejtat e personave të shoqëruar të cilët akomodohen në dhomat e shoqërimit.
6. Marrjen e masave për vendosjen e rrjetave të telit në skarat e hekurit të dritareve të dhomave të shoqërimit për të parandaluar çdo mundësi vetëdëmtimi nga personat e shoqëruar që akomodohen në këto ambiente.
7. Marrjen e masave nga Komisariati i Policisë së Lushnjes për plotësimin me saktësi të regjistrit të të miturve në konflikt me ligjin si dhe sigurimi i psikologut në çdo rast gjatë intervistimit të të miturve.
8. Marrjen e masave të menjëhershme nga Komisariati i Policisë së Lushnjes për dhënien e kartës së të drejtave personave të shoqëruar apo ndaluar në momentin e hyrjes së tyre në ambientet e komisariatit.

Për qëndrimin dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihem në dijeni brenda afatit 30 ditë sipas nenit 22 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

**i Mekanizmit Kombëtar
për Parandalimin e Torturës
(MKPT)
Ahmet PRENÇI**

d.v